


**Bahri Beci**

**Rreth historisë së formimit  
të dy dialekteve të shqipes**

# Dy krahinat dialektore ose dialektet e shqipes



## Koha e formimit të dy dialekteve të shqipes

- **J. G. Hahn është i pari dhe i vetmi që ndarjen e sotme dialektore në gegërishte dhe toskërishte e shpinte në rrethanat e kohës antike duke e vënë në lidhje me ilirishten dhe epirotishten.**
- **Sipas Hahnit, në zonën poshtë Shkumbinit deri në gjirin e Ambrakisë kanë banuar fise epirote etnikisht të një trunqu me ilirët, çka mund të ketë shërbyer si pikënisje për formimin e dy dialekteve të shqipes.**

- **« Në qoftë se ilirët dhe eprotët flasin dialekte shumë të vjetra të ndryshme të së njëjtës gjuhë, në qoftë se kufiri i ndarjes së tyre bie atje ku e vë Straboni kufirin midis epirotëve dhe ilirëve, në qoftë se epirotët nuk ishin helenë, por barbarë a nuk është këtu tepër e mundshme që edhe në kohët e lashta të ishte po kështu, ashtu siç është tani dhe që epirotët të bënin pjesë në fiset ilire ».**

## **Konkluzioni i J. G. Hahnit**

- **« Shkumbini i ndan sot gegët dhe toskët sikundër që ka ndarë që moti stërgjyshërit e tyre ilirët dhe epirotët që kishin afrim gjaku...  
»**

# Studiuesit e tjerë

- Studiuesit e tjerë pas J. G. Hahnit, albanologë të huaj dhe shqiptarë si G. Meyer, N. Jokli, K. Taliavini, E. Çabej, V. Polak, A. V. Desnickaja, J. Gjinari kanë mbrojtur pikëpamjen se dy dialektet e shqipes janë *relativisht të reja*.
- Në tekstin e «Dialektologjisë shqiptare», ndër të tjera, është shkruar « ndarja dialektore e gjuhës shqipe dhe ndarja krahinore e popullit tonë morën formën që kanë sot aty *nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX (...)*. Në këtë kohë erdhën e u dalluan *dy ndarje të mëdha krahinore, Toskëria në jug dhe Gegëria në veri ...* . Nga pikëpamja gjuhësore në këto dy zona dalloheshin dy ndarje të mëdha dialektore: *gegërishtja në veri dhe toskërishtja në jug (...)* ”.

# Pikëpamja jonë për kohën eformimit të dy dialekteve të shqipes


- **Më 1974, ne, në pajtim me J. G. Hahn, kemi pranuar se ndarja dialektore e shqipes në dy dialekte, gegërishtja në veri dhe toskërishtja në jug, është e vjetër.**

*Nga jemi nisur?*

**Fillimisht ne kemi veçuar a përcaktuar tiparet dalluese kryesore me vlerë absolute për veçimin e dy dialekteve të shqipes.**


# Tiparet dalluese kryesore me vlerë absolute të dy dialekteve të shqipes

## 1. Prania e zanoreve hundore në gegërishte dhe mungesa e tyre në toskërishte.






## 2. Prania e zanores së theksuar ë në toskërishte dhe mungesa e saj në gegërishte.







### 3. Kalimi *n*-së ndërzanore në *r* në toskërishte.



4. Prania në fillim të disa fjalëve  
e grupit tingëllor *vo-* në gegërishte,  
kurse në toskërishte e grupit *va-*.



## 5. Prania e paskajores së tipit *me punue* në gegërishte dhe mungesa e saj në toskërishte.



# **Vjetërsia e tipareve dalluese të pranuara prej nesh**

- Nga studiuesit e derisotëm janë sjellë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar që tiparet kryesore dalluese me vlerë absolute për veçimin e dy dialekteve të shqipes të pranuara më sipër prej nesh, janë përftuar para huazimeve sllave në shqipen, nga fundi periudhës antike (shekujt IV-VI) ose në Mesjetën e hershme (shekujt VI-VIII).**

## ***Kur janë shtrirë tipare dalluese të dy dialekteve të shqipes deri në afërsi të Shkumbinit?***

- Duke pasur parasysh ligjin e gjeografisë gjuhësore sipas të cilit «afria *kronologjike* pasqyrohet me anë të afrisë *gjeografike*», kemi pohuar që tiparet dalluese të dy dialekteve të shqipes të sjella më sipër, të cilat përkojnë edhe *kronologjikisht* edhe *gjeografikisht* duhet edhe të jenë përhapur pak a shumë në të njëjtën kohë.**
- Duke pasur parasysh rrethanat historike të vendit tonë duhet pranuar që këto tipare (të përfutuara para huazimeve sllave të shqipes) nuk mund të fitonin shtrirjen që kanë sot (deri në afërsi të Shkumbinit) as në periudhën e mbretërive bullgare e serbe (shek. IX-XII), as në periudhën e formimit të shtetit të Arbërit (shek. XII-XIII), po as edhe në shekujt e mëvonshëm, në kushtet e sistemit feudal ushtarak turk, kur dihet që gjatë këtyre shekujve nuk ka pasur një ndarje politike, kulturore e administrative të qëndrueshme që të favorizonte shtrirjen e këtyre tipareve deri në afërsi të Shkumbinit.**
- Shtrirja e tyre në kufijtë e sotëm duhet të jetë më e vjetër dhe duhet të lidhet me kushtet politike, ekonomike dhe kulturore të vendit tonë para pushtimit sllav, pra, në Mesjetën e hershme (shek. VI-VIII) ose në antikitetin e vonë (shek. IV-VI).**

# Shkaqet e formimit të dy dialekteve të shqipes

- **J. Erdeljanoviç: «Zhvillimi etnik i shqiptarëve në të kaluarën ka qenë bërë mbi një bazë etnike krejt të ndryshme në veri tek gegët në krahasim me toskët në Jug».**
- **V. Polak: «dukuri të tilla si përdorimi i paskajores në gegërishte, dallimi fonetik geg. *ã* tosk. *ë*, dallimet në gjatësinë e zanoreve në gegërishte, rotacizmi etj. janë rezultat i ndikimit të dyfishtë sllav, të *serbokroatishtes* në veri dhe të *bullgarishtes* ose *bullgaro-maqedonishtes* në jug».**



# Pikëpamja jonë

- Sipas nesh, para se të vështrohen lidhjet e jashtme (pra ato me gjuhët e tjera ballkanike) të tipareve dalluese të dy dialekteve të shqipes, është e domosdoshme të vështrohen më parë lidhjet e brendshme të tyre. Ato janë të tilla që ndihmojnë edhe në ndriçimin e lidhjeve të tyre të jashtme.
- Dukuri të tilla si *rotacizmi*, *mungesa e hundorësisë* dhe *alternimi ã/ë* në toskërishte, është provuar se kanë lidhje varësie e kronologjie me njëri-tjetrin.
- Po kështu *rotacizmi*, *mungesa e fonemave zanore hundore*, *prania e fonemës së theksuar ë (< ã)*, *prania e grupit të tingujve va - në fillim të disa fjalëve*, *mungesa e infinitivit të tipit me me* në toskërishte, për shkak të shtrirjes së tyre territoriale të njëjtë, duhet edhe të jenë përhapur afërsisht në të njëjtën kohë.



- Në qoftë se pranojmë që *rotacizmi* është i *periudhës parasllave*, atëherë duhet të pranojmë që edhe fenomenet e tjera (kalimi i *ã* > *ë*, i *vo* > *va*, zhdukja e infinitivit) me të njëjtën shtrirje territoriale janë pak a shumë të kësaj periudhe, gjë që do të thotë që edhe, ndarja e shqipes në dy dialekte është e kësaj periudhe (pra, para shekullit VII).
- Pra, lidhjet e brendëshme të dukurive dialektore të shqipes dëshmojnë se para depërtimeve sllave në shekullin VII-të në territorin e Shqipërisë së Jugut ka pasur lidhje politike, ekonomike dhe kulturore që janë bërë shkak i zhvillimeve dialektore të toskërishtes, çka e përjashton mundësinë e ndikimit të gjuhëve të tjera.

## Po lidhjet e jashtme me gjuhët fqinje ballkanike çfarë tregojnë?

- Disa nga këto dukuri si: *fonema zanore e theksuar lë l*, *rotacizmi*, *kalimi i vo-së në va* nuk ndeshen në greqishte, çka e përjashton mundësinë e ndikimit të greqishtes në këto zhvillime të toskërishtes.
- Këto dukuri, në tërësinë e tyre, nuk gjenden as në maqedonishte, as në bullgarishte. Por, edhe kur ekziston ndonjëra prej tyre siç është, për shembull, *prania e zanores ë të theksuar* në maqedonishte dhe bullgarishte, ajo është shumë më e re në kohë se ë-ja e theksuar e toskërishtes.
- Po kështu edhe *humbja e hundorësisë* në maqedonishte e bullgarishte është një dukuri relativisht e re. *Rotacizmi* nuk shfaqet fare në këto gjuhë.

## Lidhjet me rumanishten

- Lidhjet me rumanishten nuk mund të përjashtohen a priori. Janë të përbashkëta për shqipen jugore (toskërishten) dhe rumanishten ose dialektet e saj *mungesa e kundërvënies sipas hundorësisë dhe gjatësisë, prania e fonemës zanore të theksuar lël, rotacizmi, kalimi i vo-së në va- (në rumanisht oa), si edhe zëvendësimi i paskajores me lidhoren. Këto dukuri në toskërishte dhe rumanishte janë të hershme.*
- Disa studiues, sidomos rumunë, duke u nisur nga izoglosat e përbashkëta shqiptaro-rumune, ndër të cilat edhe dukuria e rotacizmit në toskërishte dhe në dialektet veriore rumune, e zhvendosin vendbanimin e toskëve në territorin e Dakisë, në pjesën perëndimore të saj.

- **Studiuesit që janë marrë më konkretisht nme këtë problematikë, kam parasysh studiues si P. Skok, H. Bariç dhe A. I. Balota, kanë pranuar se këto dukuri janë ndikime të shqipes mbi rumanishten.**
- **Këtu do të veçoja ato që ka shkruar Kr. Sandfeld. Sipas tij « të gjitha këto lidhje midis shqipes dhe rumanishtes nuk mund të jenë rezultat i rastësisë », « shumica e gjuhëtarëve të huaj, vazhdon ai, kanë shikuar në raportet e ngushta të shqipes e rumanishtes miratimin e faktit që ... kombësia rumune është zhvilluar në shekujt e parë të erës sonë, në jug të Danubit, në kontakt intim me shqiptarët dhe shtrirja e sotme e rumunëve i dedikohet një imigracioni të mëvonshëm ... ».**

## Konkluzioni ynë

- **Me vjetërsinë dhe shtrirjen që paraqesin dukuritë dialektore të toskërishtes nuk mund të kenë lindur e të jenë konsoliduar si të tilla në një territor tjetër e pastaj të jenë bartur së bashku me popullin në territorin e sotëm.**
- **Duhet pranuar që dy dialektet e shqipes gegërishtja në veri dhe toskërishtja në jug janë të vjetra dhe janëformuar në territoret e tyre të sotme, çka flet në mënyrë të padiskutueshme edhe për vjetërsinë e pranisë së shqiptarëve në këto territore të paktën që nga koha antike.**